



Nr./Br. 878/20
Datë/Datum. 05.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 878/20

Duke u bazuar në nenin 105, nenit 112.2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, si dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe nenin 18 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/20 si dhe duke pasur parasysh kërkesën e Autoritetit Kontraktues /Komuna e Gjilanit /, me numër të protokollit: 878/20, të datës 04.11.2020, për heqjen e obligimit të pezullimit automatik, lidhur me tenderin “Ndërtimi i Kulmit sh.m.l.t. Mehmet Isai” me numër të prokurimit :651-20-4763-5-2-1, Kryetari i OSHP-së, me datë: 05 tetor 2020 mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET, si e pabazuar kërkesa e AK-së / Komuna e Gjilanit /, për heqjen e obligimit të pezullimit automatik, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Kulmit sh.m.l.t. Mehmet Isai” me numër të prokurimit :651-20-4763-5-2-1.

II.MBETET, në fuqi obligimi i pezullimit automatik, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Kulmit sh.m.l.t. Mehmet Isai” me numër të prokurimit :651-20-4763-5-2-1 . Organi Shqyrtues i Prokurimit, do të vazhdojë me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankues me numër të protokollit 878/20, të datës 02.11.2020, në procedurë të rregullt, sipas dispozitave ligjore të LPP-së.

A r s y e t i m

Lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Kulmit sh.m.l.t. Mehmet Isai” me numër të prokurimit :651-20-4763-5-2-1, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 02.11.2020, ka pranuar ankesë nga “ NNP “CTA”SHPK Prishtinë , me nr. prot: 878/20, dhe me dt.02.11.2020 OSHP, ka njoftuar autoritetin kontraktues se kanë pranuar ankesat e lartpërmendura dhe e ka njoftuar se janë të obliguar konform nenit 112 të bëjnë pezullimin e aktivitetit të prokurimit “ Ndërtimi i Kulmit sh.m.l.t. Mehmet Isai” me numër të prokurimit :651-20-4763-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit me datën 04.11.2020, i është drejtuar OSHP-së, me kërkesën për heqje të obligimit të pezullimit automatik, lidhur me aktivitetin e lartpërmendur të prokurimit duke i dhënë sqarimet si në vazhdim:

“Komuna e Gjilanit,ka shpallur tenderin me titull ” Ndërtimi I Kulmit sh.m.l.t. Mehmet Isai” me nrte prokurimit 651-20-4763-5-2-1,dhe nr I brendshëm GL 651 20 055 521.

Kjo lënd është vlerësuar nga komisioni vlerësues, dhe është shpallur fitues O.E AVAG GROUP SH.P.K & EING COM SH.P.K, ku edhe kemi ankesë në OSHP dhe kemi bërë pezullimin e kësaj procedure.

Operatori Ekonomik NNP”CTA” SHPK nga Prishtina ka paraqitur Ankesë në Organin e juaj me dt:02.11.2020,dhe në bazë të nenit 112 par.2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, kërkojmë nga Kryetari I OSHP-së të nxjerrë urdhër për heqjen e obligimit për pezullimin automati të aktivitetit të prokurimit, lidhur me tenderin *’ **Ndërtimi I Kulinit sh.m.l.t. Mehmet Isai**”.

Duka marrë parasysh pasojat e mundshme negative që mund të ketë pezullimi I kësaj procedure dhe dëmtimi I interesit publik I qytetareve, kërkojmë nga ju që të nxjerrin një vendim për dhënien e të drejtës së vazhdimit të mëturjeshëm të procedurës për lidhjen e kontratës me tenderuesin e propozuar për kontratë, për arsye se kemi të bëjmë me një rast urgjent sepse kulmi gjatë një stuhie të forte që goditi kulmin e kësaj shkollë është dëmtuar pothuajse I gjithë kulmi I shkollës dhe gjatë të reshurave atmosferike ka filluar të dëmtohet edhe objekti I brendshëm I shkollës në tërësi, si dhe kabineti I shkollës teknike ku ka paisje të ndishme që rrezikohen të dëmtohen. Duke pasur parasysh se jemi në fillim të sezonit të dimrit dhe mos rregullimi I kulmit në kohë sa më të shkurt do të ketë dëmtime edhe më të mëdha në shkollë dhe do ti bëj të pa mundur rregullimin e dëmeve të shkaktuara.

Operatori ankues NNP”CTA” SHPK edhe në ankesën që ka parashtruar në pretendimin numër 3 ka cekur se është I pa përgjegjshëm.edhe pse është kërkuar sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë që operatorët të plotësojnë kërkesën për një punëtor Armirues dhe një punëtor Latues,Operatori ankues ka ofruar vetëm një punëtor për dy pozitat ndërsa kërkesa e AK-së ka qenë që të ofrojë ndaras një punëtor të qertifikuar si Latues dhe një punëtor të qertifikuar Armirues.(shih pretendimin nr 3 të OE ankues ku dëshmon se nuk ka ofruar 2 punëtorët e kërkuar,por në pretendimin e tij thotë se do të angazhoj 50% si Latues dhe 50% si Armirues Sikur te kishte poz te armatures ne paramasan ofertuese puntorin Fazii Gjyliqi pasi kemi dy parakontrata ne dosje si arnirues dhe si latues do te kishini <i>gazhu mv orar pune 50% si latnes tlhe 50% si annirues. Ndërsa sa I përket pretendimit numer 4: se grupi I OE AVAG GROUP SH.P.K & EING COM SH.P.K është I pa përgjegjshëm nuk qëndron sepse OE për të plotësuar këtë pike ka ofruar vetëm një reference të lëshuar nga AK Komuna e Gjilanit në vlerë prej **924,415.63** ndërsa kërkesa e AK- së ka qenë që të ofroj dëshmi për punë të kryera në vlerë prej **150,000.00**,ndërsa sa I perket pretendimit se OE AVAG GROUP SHPK nuk ka nëshkruar dhe vulosur Aneksin 6-të nuk qëndron sepse Aneksi 6-të eshte I nenshkuar dhe vulosur ne faqe 38 te dosjes se tenderit. Andaj kërkojmë nga organi

shqyrtues I prokurimit që të nxjerrë urdhërin për heqjen e obligimit për pezullim per arsyet e cekura me larte” .

OSHP e ka njoftuar operatorin ekonomik ankues se AK Komuna e Gjilanit ka kërkuar nga OSHP që të veproj në pajtim me nenin 112 paragrafi 2 të LPP-së, njeherit OSHP ka kërkuar nga operatori ekonomik ankues që të kthejnë përgjigje sa më shpejt që të jetë e mundur lidhur me prezantimin e argumenteve se përse pezullimi nuk duhet të hiqet sipas dispozitave te nenit 112.2 te LPP-së ku ndër të tjera thuhet “Para se të marrë çfarëdo veprimi mbi kërkesën e autoritetit kontraktues, ankuesit do t’i jepet mundësia që t’i dorëzojë argumente me shkrim Kryetarit të OSHP-së, lidhur me atë se pse pezullimi nuk duhet të hiqet”.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se kërkesa e AK-së, e për heqjen e pezullimit automatik për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Kulmit sh.m.l.t. Mehmet Isai” me numër te prokurimit :651-20-4763-5-2-1, nuk përmban arsye bindëse siç parashihet në neni 112. 2 të LPP-së, për faktin se arsyet e cekura nga AK-ja, në parashtrësën e datës: 04.11.2020 nuk vijnë në shprehje për rastin konkret dhe nuk janë bindëse për OSHP-në.

Kryetari i OSHP-së, e refuzon kërkesën e Autoritetit Kontraktues /Komuna e Gjilanit të dt: 04.11.2020 , si të pa bazuar konform nenit 112.2, të LPP-së, për faktin se AK nuk ka arritur të dëshmojë se interesi publik për heqje të pezullimit automatik është më i madh se respektimi i afateve kohore për shqyrtim të ankesës. Andaj OSHP do te vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik i cili ka parashtruar ankesë në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Me rastin e marrjes së këtij vendimi, kryetari i OSHP-së pati AK nuk ka dhënë asnjë argument bindës për heqjen e këtij pezullimi dhe se aktiviteti i prokurimit nuk përfshin situata sipas vendimit të Qeveris së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, te datës 15.03.2020, dhe Njoftimin e KRPP-së te datës 16.03.2020. Gjithashtu Kryetari i OSHP-së, pati parasysh që mundësia e dëmtimit të buxhetit të Kosovës, mund të jetë evidente dhe me pasoja të mëdha, nëse eventualisht do të ndryshonte rezultati final, pas shqyrtimit të ankesës se operatorit ekonomik ankues, pasi që nëse hiqet obligimi i pezullimit automatik dhe nënshkruhen kontratat, e më pastaj nëse eventualisht operatori ekonomik ankues do ti aprovohej ankesa, do të ndryshonte rezultati final, duke ardhur në një situatë ku duhet të shkëputet kontrata, e të lidhet kontratë tjetër me operator ekonomik tjetër, atëherë dëmtimi i buxhetit të Kosovës do të ndodhte, për shkak të pakujdesisë dhe mos inicimit me kohë të aktivitetit të prokurimit nga ana e autoritetit kontraktues. Kryetari i OSHP-së sqaron se shqyrtimi në mënyrë të rregullt i ankesave nuk paragjykon rezultatin final të këtij aktiviteti të prokurimit. Nga te cekurat si me lart Kryetari nuk e sheh arsye për aprovim te heqjes se pezullimit automatik për rastin në fjalë. Andaj konstatojmë se do të vazhdohet me shqyrtimin e rregullt te ankesës së OE ankues dhe se

shqyrtimi në mënyrë të rregullt i ankesës së OE “NNP “ CTA” SHPK Prishtinë, nuk paragjykon rezultatin final të këtij aktiviteti të prokurimit.

Kryetari i OSHP-së, nga provat e prezantuara më lart, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura në afat prej 30 ditësh mund të ushtrojnë padi, pranë gjykatës themelore në Prishtinë – në departamentin për çështje administrative.

Kryetari i OSHP-së

Z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 AK- Komuna e Gjilat
2. OE ankues. NNP CTA” SHPK Prishtinë
3. 1x1 Arkivës së OSHP-së.